



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova - Kosovo Judicial Council

Komisioni për Trajnime
Committee for Training - Komisija za Obuke

RAPORT I AKTIVITETEVE PËR PËRMBUSHJEN E PLANIT TË PUNËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, janar 2024



Në vend të parathënies,

Të nderuar anëtar të KGJK-së,

Kam kënaqësinë që në emër të Komisionit për Trajnime të paraqes aktivitetet për përmbushjen e Planit të Punës së Komisioni për Trajnime përgjatë vitit 2023.

Komisioni ka ndërmarrë veprime dhe aktivitete të rëndësishme të cilat kanë pasur rëndësi për përmbushjen e planit të punës së komisionit. Sikurse në vitet e kaluara, edhe këtë vit na ka përcjellë sfida e organizimit të komisionit, pasi kryetari i komisionit dhe anëtarët e tjera nuk parashihen të jenë me orar të plotë, që d.m.th. detyrat e tyre primare ngelen detyrat e tjera dhe jo përgjegjësitë e komisionit. Gjithashtu, trajnimet ende nuk shihen si prioritet nga të punësuarit në administratën gjyqësore, veçanërisht nga bartësit që sipas Ligjit për Zyrtarët Publik e kanë për detyrim t'i përmbushin përgjegjësitë e tyre ligjore, por edhe me Rregulloren e re për Trajnimin e të Punësuarve në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Një nga anëtarët e Komisionit për shkak të gjendjes në veri të RKS-së, ka pasur probleme të vijë në objektin e Këshillit dhe rrjedhimisht është hendikepuar komisioni në aspektin e organizimit dhe kryesisht përgjegjësitë janë përmbushur nga kryetari i Komisionit.

Përmbushja e objektivave të punës në këtë dokument është bërë sipas renditjes që kanë në planin e punës dhe për përmbushjen e tyre janë dhënë shpjegime të qarta me evidencë konkrete.

Me respekt!

Prof. Asoc. Dr. Vilard Bytyqi

Kryetar i Komisionit për Trajnime





Objektivi 1 - Vlerësimi i nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe nxjerrja e rekomandimeve konkrete

Komisioni për Trajnime ka analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të gjërësishme situatën e nevojës për trajnime, gjë që ka nxjerrë disa raporte të veçantë, përfshirë nevojën për trajnime për Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, pastaj ka analizuar gjendjen e trajnimeve në Gjykatën Komerciale, ku ka dhënë komente në vlerësimet e bëra nga ekspertja e angazhuar e USAID. Gjithashtu ka marrë pjesë në hartimin e planit të trajnimeve për vitin 2024 me Akademinë e Drejtësisë dhe me rekomandime konkrete të nxjerra nga takimet e mbajtura të Komisionit të Trajnimeve janë dhënë rekomandimet tek Akademia e Drejtësisë për ri-dizajnimin e trajnimeve, dhe të njëjtat janë marrë në konsideratë nga Akademia e Drejtësisë.

Objektivi 2 - Përcaktimi i standardeve dhe hartimi i kurrikulës për gjyqtarë porotë

Komisioni i Trajnimeve në bashkëpunim me Këshillin dhe në koordinim me Akademinë e Drejtësisë ka hartuar dhe përcaktuar standardet e trajnimit, përkatësisht kohëzgjatjen dhe përmbajtjen e trajnimit fillestar për gjyqtarët porotë. Tanimë përmbajtja dhe kohëzgjatja e trajnimit teorik dhe praktikë për gjyqtarët porotë është e përcaktuar me vendim të veçantë të miratuar në KGJK.

Gjithashtu Komisioni për Trajnime ka përcaktuar edhe kurrikulën trajnuese, përfshirë temat trajnuese në fushat relevante, civile, penale dhe multidisiplinare, si fusha të rëndësishme dhe prioritare të natyrës së këtij funksioni.



Objektivi 3 - Zbatimi i trajnimit për gjyqtarë porotë

Trajnimi teorik për gjyqtarët porotë është zhvilluar në Akademinë e Drejtësisë nga data 22 deri 25 qershor 2023, ndërsa trajnimi praktik është zhvilluar nga gjykatat themelore dhe në degët përkatëse. Numri i përgjithshëm i personave të trajnuar përgjatë vitit 2023 në funksionin e gjyqtarit porotë është 85. Pas përfundimit të trajnimit të gjithmbarshëm, me vendim të Këshillit janë emëruar si gjyqtarë porotë.

Numri i përgjithshëm i personave që janë emëruar si gjyqtarë porotë nga Këshilli për vitin 2023 është 85, mirëpo një gjyqtar porotë ka dhënë dorëheqje.

Objektivi 4 - Vlerësimi i nevojave administratën gjyqësore trajnuese

Gjatë vitit 2023 Komisioni i Trajnimeve ka realizuar takime të drejtpërdrejta dhe ka bërë vlerësime të përgjithshme lidhur me zbatimin dhe planet e trajnimeve për Administratën Gjyqësore. Nga takimet e zhvilluara me bartësit e funksioneve në SKGJK dhe në administratën e gjykatave, është vlerësuar se duhet pasur trajnime fillestare dhe trajnime të vazhdueshme.

Në funksion të kësaj, është hartuar Rregullorja për Trajnimin e të Punësuarve në Sistemin Gjyqësor, e cila është hartuar nga kryetari i Komisionit për Trajnime, dhe më pas ka kaluar nga Komisioni për Çështje Normative dhe për miratim në Këshill.

Për qëllime të njëjta është hartuar edhe raporti për vlerësimin e nevojave trajnuese e cila është shpalosur në një nga punëtoritë e mbajtura të KGJK-së gjatë vitit 2023.



Objektivi 5 - Hartimi i planit të trajnimeve për të punësuarit në administratën gjyqësore

Meqenëse në këtë vit janë zhvilluar vlerësime dhe është hartuar rregullorja, në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë është hartuar një plan dinamik – plan veprimi, që ka përfshirë disa kategori të të punësuarve për të cilët Akademia ka module të gatshme dhe të përgatitura, përkatësisht bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor, i cili është zhvilluar në Akademinë e Drejtësisë.

Akademia nuk ka plane trajnimi për të gjithë të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor. Edhe pse në mandatin e saj ligjor e ka trajnimin e të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor, deri më tani me krejtësisht pak mundësi ka vepruar dhe për këtë arsye edhe në rregulloren e re, janë paraparë mundësia e zhvillimit të trajnimeve të brendshme, për t'iu shmangur pamundësisë që të punësuarit të ngelen të pa trajnuar, e veçanërisht të punësuarit e rijnë të cilët e kanë të drejtë dhe detyrim ligjor sipas Ligjit për Zyrtarët Publik të ndjekin trajnimin fillestar me rastin e punësimit të tyre.

Objektivi 6 - Zbatimi dhe mbikëqyrja e planit për trajnime për të punësuarit në administratën gjyqësore

Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar dhe zbatuar planin për trajnime gjatë vitit 2023. Në këtë rast janë trajnuar disa kategori të të punësuarve, përkatësisht bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor, zyrtarë nga zyra për Menaxhimin e Lëndëve, Trajnime për Protokoll dhe trajnime të tjera.



Objektivi 7 - Rishikimi i standardeve, rregullave dhe politikave të trajnimit të gjyqtarëve dhe bartësve tjerë të funksioneve menaxheriale në sistemin gjyqësor

Nevoja për ta hartuar një analizë lidhur me trajnime është ide e mëhershme e cila kishte për synim parësor të bëjë një analizë identifikuese të pikave të forta dhe pikave të dobëta lidhur me trajnimet nga perspektiva e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Nga diskutimet e brendshme u pa e nevojshme se disa rregulla dhe standarde lidhur me trajnimet duhet të rishikohen, pasi të njëjtat u vlerësuan se kanë nevojë për tu ri-parë nga aspekti i funksionalitetit dhe efektivitetit në praktikë.

Për këto arsye, Komisioni i Trajnimeve në mënyrë aktive ka mbledhur dhe analizuar të dhëna, informacione, praktika, rregulla dhe standarde, si dhe nga përvoja krahasuese, duke bërë të mundshme të hartohet raporti analitik për çështje të trajnimeve nga perspektiva e Këshillit. Ky dokument ka shërbyer si bazë për të bërë rishikimet e rregullave dhe standardeve të rregullores për trajnime. Nga ky raport është draftuar edhe rregullorja për trajnimin e gjyqtarëve e hartuar nga Komisioni i Trajnimeve.

Nga hartimi i rregullores së re, fondi i detyrueshëm i ditëve trajnuese është hequr. Gjithashtu kryetarët e gjykatave janë liruar nga trajnimet si gjyqtarë, duke u përqendruar në trajnime si udhëheqës dhe menaxher, përfshirë këtu edhe gjyqtarët mbikëqyrës. Gjithashtu janë rishikuar të gjitha procedurat e aplikimi, aprovimit, vijimit dhe informatën kthyesë që do ta japin gjyqtarët. Gjithashtu janë avancuar dhe forcuar rregullat ligjore lidhur me trajnimet jashtë vendit dhe aspekte të tjera.



Objektivi 8: Funkcionalizimi i ndërlidhjes së data-bazave ndërmjet KGJK dhe Akademisë së Drejtësisë

Kemi mbajtur takim me Drejtorin e Akademisë, dhe tani sekretarja e komisionit ka qasje në data bazën e tyre, gjithashtu në baza javore njoftohemi nga Akademia për aktivitetet e Akademisë, ku marrin pjesë gjyqtarët si trajnues dhe si të trajnuar. Akademia e ka marrë përsipër që këtë aktivitet duhet ta përmbush, pasi parashihet edhe me Strategjinë për Sundimin e Ligjit, dhe se Akademia e Drejtësisë është bartëse e këtij aktiviteti, ndërsa KGJK është partnere zbatuese.

Objektivi 9: Identifikimi i temave për trajnimin e detyrueshëm për fusha të caktuara për gjyqtarë, si dhe të gjyqtarëve individual dhe adresimi tek Akademia e Drejtësisë

Komisioni i Trajnimeve ka analizuar se cilat tema mund të jenë të detyrueshme, dhe kjo ndërlidhet veçanërisht me ndryshimet në legjislacionet dhe ato që ndërlidhen me aspektet e jurisprudencës së GJEDNJ apo GJK të RKS. Në këtë ndërlidhje, Komisioni i Trajnimeve është duke punuar që ta kemi edhe një protokoll të veçantë me një memorandum me Akademinë e Drejtësisë, që në situatat kur kemi rekomandime për trajnime të cilat dalin nga vlerësimet e performancës, ta kemi bazën e duhur që këto të adresohen konkretisht tek Akademia e Drejtësisë.

Gjithashtu në planin trajnues për vitin 2024 të Akademisë e Drejtësisë janë dhënë rekomandime konkrete dhe në punëtorin e organizuar nga Akademia e Drejtësisë, Komisioni i Trajnimeve ka marrë pjesë në mënyrë aktive dhe në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka prezantuar vizionin për trajnime për vitin 2024, gjë që Akademia e Drejtësisë i ka marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet e dhëna. Komisioni i Trajnimeve ka punuar edhe në planin e veprimit për trajnime për gjyqtarë dhe nga ky dokument janë dhënë zgjidhje të drejta dhe të përshtatshme për menaxhim më të mirë dhe më cilësor nga udhëheqësit e drejtpërdrejt, si kryetarë gjykatash, por edhe menaxhim më të mirë të resurseve dhe aspekteve të rëndësishme.



PËRMBLEDHJE

Bazuar në aktivitetet e Komisionit për Trajnime në një tërësi dhe objektivat e punës gjatë vitit 2023 të parapara me Planin e Punës së Komisionit, konkludojmë se të gjitha aktivitetet e parapara janë përmbushur. Ngelet që në vitin 2024 të zgjerohet vëllimi i përmbushjes tek trajnimi i të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor.